



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3783/ 43 prot.

Datë 30.04.2025

V E N D I M
Nr. 587/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.529/2025, datë 17.04.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-22509-10-02-2024, me objekt: “Lot. 7 “Drug-eluting stent for restenosis- stenta të medikuara për restenozë” me fond limit 158,026,510.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale

Ankimues: “Fedos” SHPK me NIPT K01514009I dhe adresë: Rruga “Kujtim Laro” - Tiranë, Nr.pasurie 3/22,Kati 2, Tiranë

BOE “O.E.S Distrimed” SHPK & “Montal” SHPK, me NIPT K31520054N dhe J62009007F dhe adresë: Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, pallati "Kastrati"

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me adresë: Rruga e Kavajës Nr.1001, Tirana, Albania

Subjekte të Interesuara: BOE “O.E.S Distrimed” SHPK & “Montal” SHPK, me NIPT K31520054N dhe J62009007F dhe adresë: Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, pallati "Kastrati"

“Fedos” SHPK me NIPT K01514009I dhe adresë: Rruga “Kujtim Laro” - Tiranë, Nr.pasurie 3/22,Kati 2, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 17.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.529/2025, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Fedos” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-22509-10-02-2024, me objekt: “Lot. 7 “Drug-eluting stent for restenosis- stenta të medikuara për restenozë” me fond limit 158,026,510.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.*
3. *Të mos pranojë ankesën e BOE ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Montal” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.*
4. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
5. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
6. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK.*
7. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga nga BOE ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Montal” SHPK.*
8. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
9. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.76/19 prot., datë 29.04.2025, protokolluar me tonën nr. 3783/40 prot., datë 30.04.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 529/2025 datë 17.04.2025 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin përmbledhës të rivlerësimit të KVO-së.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.76/19 prot., datë 29.04.2025, protokolluar me tonën nr. 3783/40 prot., datë 30.04.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 529/2025 datë 17.04.2025 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin përmbledhës të rivlerësimit të KVO-së.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka kualifikuar operatorin ekonomik “Fedos” SHPK në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.529/2025 datë 17.04.2025.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, ka zbatuar vendimin Nr.529/2025 datë 17.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-22509-10-02-2024, me objekt: “Lot. 7 “Drug-eluting stent for restenosis- stenta të medikuara për restenozë” me fond limit 158,026,510.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-22509-10-02-2024, me objekt: “Lot. 7 “Drug-eluting stent for restenosis- stenta të medikuara për restenozë” me fond limit 158,026,510.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

